



**KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**  
**KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE**

**Drejtoria e Administrimit të të Dhënave dhe Sistemeve**

|          |  |
|----------|--|
| Data     |  |
| Nr. Prot |  |

**RELACION**  
**PËR**  
**PROJEKTVENDIMIN**  
**PËR**  
**PËRDORIMIN E KODEVE TË SIGURISË PËR PAJISJEN ELEKTRONIKE TË VOTIMIT DHE**  
**NUMËRIMIT ELEKTRONIK TË ZGJEDHËSVE**

**I. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJSLACIONIN NË FUQI**

Neni 19, pika 1, shkronja “n” dhe pika 2, neni 22, pikat 1, 3 e 5 dhe neni 99, pika 2, shkronja “dh”, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, ka parashikuar kompetencën e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve në lidhje me teknologjinë në zgjedhje, duke vënë në përdorim sisteme ose pajisje të teknologjisë së informacionit.

**II. PËRMBLEDHJE SHPIEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTVENDIMIT**

Referuar nenit 19, pika 1, shkronja “n” dhe pika 2, nenit 22, pikat 1, 3 e 5, dhe nenit 99, pika 2, shkronja “dh”, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve dërgon në Komisionet e Zonave të Administrimit Zgjedhor (KZAZ), materialet zgjedhore që duhet të përdoren nga KZAZ-të përgjatë periudhës zgjedhore me qëllim administrimin e procesit zgjedhor.

Mbështetur në përcaktimet e nenit 22 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, vënia në përdorim e sistemeve apo pajisjeve të teknologjisë së informacionit, bëhet për të mundësuar transparencën, efikasitetin, gjithëpërfshirjen dhe sigurinë e procesit zgjedhor.

Bazuar në përcaktimet e nenit 99, pika 2, shkronja “dh”, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve përsa parashikon kjo dizpozitë krahas materialeve zgjedhore dërgon në KZAZ, mjete të tjera të nevojshme sensitive për procesin e votimit, sikurse janë dhe kodet e sigurisë që janë të pajisura



me “QR barcode”, të cilat sigurojnë integritetin e materialeve zgjedhore që do të përdoren për identifikimin e zgjedhësve si dhe administrimin e të të dhënave të votuesve.

Për sa më lart në këtë relacion, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, brenda kompetencave të veta dhe në respektim të detyrimeve e afateve ligjore të përcaktuara në ligjin nr.10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, shqyrton dhe miraton projektvendimin “Për përdorimin e kodeve të sigurisë për pajisjen elektronike të votimit dhe numërimit elektronik të zgjedhësve”.

|                          |                                                                       |
|--------------------------|-----------------------------------------------------------------------|
| <b>Labeate ZENELI</b>    | Specialist, Drejtoria e Administrimit të të Dhënave dhe Sistemeve IT  |
| <b>Jona JOSIFI</b>       | Shef Sektor, Drejtoria e Administrimit të të Dhënave dhe Sistemeve IT |
| <b>Daniela ALIMEMETI</b> | Drejtoria e Administrimit të të Dhënave dhe Sistemeve IT              |
| <b>Majlinda ÇELMETA</b>  | Drejtoria e Përgjithshme e Administrimit të Zgjedhjeve                |
| <b>Ylli MERKAJ</b>       | Sekretar i Përgjithshëm                                               |





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: DD MM VVVV

Nr: 000-000

Ora: HH:MM

PROJEKTVENDIM

PËR

**PËRDORIMIN E KODEVE TË SIGURISË PËR PAJISJEN ELEKTRONIKE TË VOTIMIT DHE NUMËRIMIT  
ELEKTRONIK TË ZGJEDHËSVE**

Në mbështetje të nenit 19, pikat 1, shkronja “n”, e 2, nenit 22, pikat 1, 3 e 5, dhe nenit 99, pika 2, shkronja “dh”, të ligjit nr. 10019 datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe pikave 10, shkronja “f”, e 12, të vendimit nr. 4, datë 13.11.2020, të Komisionit Rregullator, “Për llojin dhe karakteristikat teknike që duhet të plotësojnë sistemet dhe pajisjet e votimit dhe numërimit elektronik të zgjedhësve që prokurohen dhe përdoren në zgjedhje në Republikën e Shqipërisë”, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve,

**VENDOS:**

1. Përdorimin e kodeve të sigurisë për mbylljen e çdo komponenti të brendshëm dhe/ose porte komunikimi fizike të Pajisjeve Elektronike të Votimit dhe Numërimit Elektronik të zgjedhësve (PEVN), si dhe për mbylljen e valixhes për transportimin e PEVN, nga këtu e vijim referuar si Kodet e Sigurisë PEVN.
2. Qëllimi, funksionaliteti dhe karakteristika të përgjithshme të Kodeve të Sigurisë PEVN përshkruhen në Lidhjen nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

1

Data: dd mm vvvv Nr: 123-456  
Ora: hh:mm



Për miratimin e materialeve zgjedhore që do të përdoren për identifikimin elektronik të zgjedhësve

1

3. Përcaktimi i sasive të Kodeve të Sigurisë PEVN, si dhe i kriterëve e specifikimeve teknike të tjera veçmas atyre që përmban Lidhja nr. 1, bëhet në përputhje me parashikimet e legjislacionit përkatës në fushën e prokurimeve publike.
4. Ngarkohet administrata e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për zbatimin e këtij vendimi.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
6. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

**Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**  
**Ilirjan CELIBASHI**

**Lidhja 1**

| Materiali zgjedhor  | Përdorimi                                                                                              | Karakteristika të përgjithshme                                                                                                                          | Karakteristika të veçanta                                                                                                                                                                                                                             |
|---------------------|--------------------------------------------------------------------------------------------------------|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| Vula me kod sigurie | 1. Shërbejnë për vulosjen e të gjitha valixheve të transportit ku mbahet pajisja e votimit elektronik. | Vulat e sigurisë, kryejnë ruajtjen e kontrolleve të aksesit të sigurisë fizike;                                                                         | Vulat e sigurisë do kenë një gjatësi të përcaktuar, fleksibël, qendrueshmëri këputjeje për të garantuar paprekshmërinë;                                                                                                                               |
|                     |                                                                                                        | Vulat e sigurisë, janë të montueshme me një proces të vetëm pa nevojën e mjeteve ndihmëse;                                                              | Përbërësit kimikë të vulës, do jenë të tillë që t'i bëjnë ballë kushteve atmosferike, nuk plasariten, nuk deformohen apo nuk ç'ngjyrosen për shkak të ndryshimeve atmosferike;                                                                        |
|                     |                                                                                                        | Ngjyra e këtyre vulave përcaktohet në varësi të procesit zgjedhor dhe procesit të punës;                                                                | Konfigurimi i vulës do të jetë i tillë në mënyrë që fshirja ose rishkrimi i numrit të serisë, të lënë gjurmë;                                                                                                                                         |
|                     | 2. Gjithashtu këto vula shërbejnë dhe për sigurimin e portës së usb-së, ekranit votimit.               | Vulat e sigurisë janë fleksible, rezistente dhe kanë konfigurim që e bën të pamundur tërheqjen e telit;                                                 | Prodhimi i vulës do të bëhet me numra serialë të ndryshëm, 6 shifror serial/ laser print/ QR barcode/ "KQZ"- tekst;                                                                                                                                   |
|                     |                                                                                                        | Vulat e sigurisë kanë dizajn, përmbajtje kimike, peshë, diametër, madhësi fizike, ngjyrë, sipas specifikimeve të kërkuara duke ruajtur koston optimale. | Përdorimi i ngjyrave do jetë me kontrast të lartë të bar kodit ( <i>e bardhë e verdhë</i> ) e ndryshme nga kodet e brendshme ( <i>ngjyrë të veçantë për vulat që do të përdoren për mbylljen e kutive dhe ngjyrë të ndryshme për vulat rezervë</i> ). |